



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq



Dalës-Izlazne
Nr. UI-76 Data 15.02.2022
Br. Datum

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	15 shkurt 2022
Nga/Od/From:	Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës
Për/Za/To:	-Kryesuesen e Kuvendit Komunal – Vjora Mjekiqi Kabashi -Anëtarët e kuvendit komunal Obiliq
Tema/Subjekat/Subject	Raporti i punës së Kryetarit të komunës për vitin 2021



*E nderuar Kryesuese e Kuvendit Komunal
Të nderuar anëtar të kuvendit komunal*

Bazuar në nenit 58, pika j të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 te dt. 04.06.2008), neni 72 pika 1.10 e statutit të Komunës së Obiliqit Nr. I-34 të datës 25.04.2016.

Ju sjellim raportin për punët e përfunduara gjatë periudhës Janar – dhjetor 2021.

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS - JANAR – DHJETOR 2021

Shkurt 2022



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Bazuar në nenit 58, pika j të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 te dt. 04.06.2008), neni 72 pika 1.10 e statutit të Komunës së Obiliqit Nr. I-34 të datës 25.04.2016. Ju sjellim raportin për punët e përfunduara gjatë periudhës Janar – dhjetor 2021.

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS - JANAR – DHJETOR 2021

Obiliq, 2022

PËRMBAJTJA

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS	3
1.Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	5
2.Drejtoria e Arsmit:.....	8
3.Drejtoria e Infrastrukturës	13
4.Drejtoria e Shëndetësis dhe Mirëqenies Sociale.....	15
5.Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisë:.....	32
6.Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjeca.....	35
7.Drejtoria e Inspektionit.....	39
8.Drejtoria e Urbanizmit:.....	40
9. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.....	42
10. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:.....	44
11. Zyra Ligjore: Raporti i Punës.....	47
12. Zyra e Personelit:.....	48
13. Zyra për të drejta të njeriut dhe komunitete.....	50
14. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.....	52
15. Zyra e Prokurimit:.....	58

FJALA E KRYETARIT

E nderuara Kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë, përfaqësues të institucioneve të komunës, shoqërisë civile dhe mediave

Fillimisht më lejoni që të uroj suksese legjislativës së re të Kuvendit Komunal, duke shprehur bashkëpunimin e plotë në këtë mandat të ri qeverisës dhe njëkohësisht të prezentoj para jush raportin vjetor (janar-dhjetor 2021) të punës së ekzekutivit komunal. Ky raport përmbanë rezultatet e arritura, punët, angazhimet dhe vështirësitë më të cilat është përballur Komuna e Obiliqit gjatë kësaj periudhe kohore.

Edhe viti që lëmë pas, është shoqëruar me sfidat në ballafaqimin me pandeminë Covid-19, si institucion komunal menaxhimin e kësaj pandemie e vumë në plan të parë e kjo po vazhdon edhe më tutje, realizuam mbështetjen e nevojshme për të gjithë të atakuarit me këtë virus, duke bërë subvencionimin e tyre me nga 100 € si dhe me nga 300 € për familjarët që kanë humbur më të dashurit e tyre. Komuna e Obiliqit u rendit në komunat e para saj përket mënyrës së administrimit të vaksinimit masiv të qytetarëve e cila u realizua në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, sipas vlerësimeve të MSH-së, komuna e Obiliqit është shembull në menaxhimin e procesit të imunizimit të qytetarëve.

Ne, edhe gjatë këtij viti jemi angazhuar fuqishëm në rritjen e transparencës komunale dhe ofrimin e shërbimeve sa më të shpejta e efikase për qytetarët e Obiliqit si rrjedhojë e kësaj në Grantin e Performancës Komunale të MAPL-së , komuna e Obiliqit është renditur ndër komunat e para me performancën dhe qeverisje të mirë duke fituar grantin në vlerë prej 374,298.57€ si dhe në kuadër të përkushtimit për mjedis të pastër, kemi fituar grant prej 82,359.00€.

Prej të arriturave kyçe të vitit, shënohet themelimi dhe funksionalizimi i NPL “Kastrioti” SH.A, ndërmarrje kjo e rëndesishë së jashtëzakonshme për qytetin e Obiliqit dhe qytetarët e tij.

Gjatë vitit 2021, kemi bërë implementimin e projekteve dhe investimeve kapitale në çdo lagje, lokalitet e fshat të komunës së Obiliqit si dhe kemi realizuar projekte të rëndësishme përmes marrëveshjeve të shumta bashkëpunimi:

Përruam sheshin “Adem Preniqi”, një hapësirë e re dhe moderne e përshtatshme për të gjitha grupmoshat.

Realizuar projektin e trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Plemetin, projekt ky në bashkëfinancim me GPK (Grantin e Performancës Komunale).

Fillimi i punimeve për ndërtimin e brezit të gjelbërt të Kosova (A), projekt ky në bashkëfinancim me GPK (Grantin e Performancës Komunale).

Ndërtimi i urës metalike për këmbësorë në fshatin Graboc dhe ndërtimi i urës së kalushme për vetura, të cilat ishin dëmtuar si rezultat i vërshimeve.

Fillim i punimeve për ndërtimin e çerdhes publike në fshatin Mazgit.

Përrurimi i shkollës në fshatin Hade e Re dhe fillimi i procesit mësimor në këtë shkollë,

Rrërimi i objekteve të vjetëruara dhe të demoluara të tregut të qytetit dhe ndërtim i parkingut publik, një kërkesë e kahmotshme e qytetarëve.

Vazhdimi i projektit të koogjenerimit; ndërtimi i objektit të ngrohjes qendrore.

Në infrastrukturen lokale, kemi vazhduar kompletimin me asfaltim dhe infrastrukturë përcjellëse nëntokësore në rrugë dhe segmente nëpër zonat e qytetit dhe ato rurale.

Me KRU “Prishtina” kemi nënshkruar memorandum bashkëfinancimi në realizimin e projektit “Ndërrimi i gypit të ujit material çelik me diameter DN 500 mm në gyp HDPE me diameter 560 mm”.

Me Islamic Relief Kosova kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi për realizimin e projektit; “Kujdesi shtëpiak për lehonat, për personat e moshës së tretë (3) dhe me aftësi të kufizuara” përmes të cilit kemi angazhuar njëmbëdhjetë (11) profesionistë shëndetësor për dhenien e shërbimeve në teren, si dhe për projektin;

“Mbështetje e qëndrueshme e jetesës për familjet në nevojë, përmes fermave të vogla bujqësore dhe me bagëti”.

Me N.H “Ibër-Lepenc” kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi për realizimin e projektit “Ujitja e kulturave bujqësore për fermerët dhe bujqit e komunës së Obiliqit”, ku

komuna e Obiliqit do bartë shpenzimet për ujitjen e kulturave bujqësore sipas kërkesës së 300 fermerëve të cilët do jenë përfitues të këtij projekti.

Përmes memorandumit me shoqatën humanitare “Jetimat e Ballkanit” kemi ndërtuar dhe përruruar 18 shtëpi për 18 familje në nevojë.

Me shoqatën humanitare “Nënë Tereza” kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi për përkrahjen e kategorisë së moshës së tretë (3), të vetmuar dhe të atakuar nga pandemia Covid-19 në zonen e qytetit por edhe në zonat rurale, me fokus të veçantë për gratë që u takojnë grupeve të cenushme të shoqërisë,

Me BeetRoot Academy, kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi për “Zhvillimin etë rinjëve të Obiliqit në fushën e IT-së”, përmes të cilit do bëhet edukimi dhe trajnimi i njëqind (100) të rinjëve të Obiliqit, komuna do të sigurojë bursa për rekrutimin e këtyre të rinjëve.

Në kuadër të kategorisë së subvencionimit, në sektorin e bujqësisë, kemi mbështetur të gjithë ata të cilët ishin të dëmtuar nga breshëri dhe vërshimet, më pastaj përkrahjen; me paisje bujqësore, subvencionim me serra, motokultivatorë, subvencionim me bletë dhe paisje elektrike të centrifugave për bletarët. Në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, vazhduam përkrahjen e tyre përmes thirrjeve publike, sepse i gjithë përkushtimi ynë është i fokusuar në fuqizimin dhe avancimin e të rinjëve dhe të rejave puntorë e të talentuar të Obiliqit. Në fushën e shëndetësisë, kemi vazhduar subvencionimin e grave lehona në shumë prej 150.00€, duke dëshmuar përkushtimin e qeverisjes sime në përkrahjen e jetës, prindërve e fëmijëve. Në arsim, mbetemi të angazhuar në ngritjen e cilësisë së arsimimit dhe edukimit të brezave të rinjë, edhe në këtë vit, shpërndamë mbi 1000 bursa dhe kartela për kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënësit, studentët e të gjitha niveleve të studimit (bachelor, master, për studime post-diplomike).

Viti 2021 shënojë përmbylljen e një mandati katër (4) vjeçar të punës sonë si ekzekutiv komunal, por edhe shënojë kurorëzimin e përkushtimit tonë të përbashkët në shërbimin e qytetarëve me një mandat të ri, për mua si kryetar komune mandati i tretë (3) qeverisës, me këtë rast zotohem se sikur deri më tani kryefjala e qeverisjes do jetë qytetari i Obiliqit, projektet bashkë do t'i zgjedhim, bashkë do t'i mbikëqyrim dhe së bashku do t'i gëzojmë.

Për fund, me lejoni të falënderoj të gjithë qytetarët e Obiliqit për besimin që bashkë të vazhdojmë punët e projektet e mira për qytetin tonë si dhe të ritheksoj se ka shumë punë, sfida e përgjegjësi përpara nesh, por angazhimi ynë për të realizuar projekte madhore, nuk do të mungojë, prandaj ju ftoj që të jemi unik dhe të bashkuar në avancimin e shërbimeve për qytetarët dhe për zhvillimet e ardhshme në komunën e Obiliqit.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS – RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-31.12.2021

Drejtoria e administratës në kuadër të kompetencave të saj, edhe për kundër Pandemisë COVID-19, ka arritur t'i realizoj objektivat e saj sipas planit të punës për vitin 2021.

Punët administrative janë kryer jo vetëm në shërbim të organeve të tjera të administratës, por edhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e komunës së Obiliqit.

-Sektori i Administratës së Përgjithëshme

Sektori kryen të gjitha punët profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ.

- përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, prokurimit dhe njësive kërkuese.
 - Përgjigjja në të gjitha kërkesat e qytetarëve drejtuar kryetarit, bordit të drejtorëve, po ashtu kemi bërë
 - lëshimin e vërtetimeve për qëndrim në Kosovë për qytetarët e diasporës, gjithsejtë janë lëshuar 40 vërtetime.
 - Kuvendi Komunal ka mbajtur - 12/ mbledhje të rregullta, 1/mbledhje inaguruese, (58 -vendime, 2- rregullore)
 - Komitetit për Politik dhe Financa- 10- mbledhje të rregullta,
 - Komitetit për Komunitete- 11- mbledhje të rregullta
 - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur - 4 mbledhje.
 - kemi pasur 11 kërkesa për qasje në dokumentet publike – zyrtare të aprovuara.
 - Kryetari i Komunës ka raportuar me dt.23.03.2021- Raportin vjetor për vitin 2020.
 - Kryetari i Komunës ka raportuar në çdo tre muaj për gjendjen financiare
 - Raporti Financiar Janar –Mars 30.04.2021
 - Drafte korniza afatmesme buxhetore (KAB) për vitin 2022-2024, me dt.29.06.2021
 - Rishikimi I Buxhetit Komunal –me 30.07.2021, me dt.30.07.2021
 - Raporti Financiar Janar –Qershor -2021, me dt. 31.08.2021
 - Aprovimi i buxhetit për vitin 2022, me dt.30.09.2021
 - Raporti Financiar Janar –Shtator për vitin 2021, me dt. 29.10.2021
- përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK-se dhe komiteteve obligative, rregulloreve, vendimeve dhe materialeve tjera sipas kërkesës së drejtorive.

- Zyrtarja e depos

Pranimi dhe evidenca e saktë për mallin e pranuar dhe për mallin e shpërndan si dhe futjen e të dhënave në friballanc, gjate vitit raportues kemi pasur 803 procedura për mallin e pranuar dhe te shpërndarë, ne shume prej 66,857.19 €.

Arkivi

- Zyra e arkivës (shkrimorja) e komunës mbahet në mënyrë elektronike-manuale, ne këtë periudhe janë proceduar – 7.472 lëndë.
- Ekspeditivi i postës te lëndëve jashtë komunës-për institucione tjera përmes postës - 320 lëndë.
- lëndë te postes për institucionin e komunës-432 lende dhe
- 83- saktësime.

Zyra për Shërbime për qytetarët

- Punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshillat e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre,
 - Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, për periudhën raportuese, janë:
 - te miratuara **16.021** lëndë,
 - te refuzuara- **1.019** lëndë,
 - në proces- **549** lëndë,
 - te anuluar-**328** lëndë,
 - të pezulluara -**6** lëndë.
 - Te hedhura poshtë-**9** lëndë
 - Te përfunduara-**17.627** lëndë
 - Te pranuar- **28** lëndë
- Gjithsejtë - 35,587 lëndë.

Zyra e ofiqarisë

Në këtë zyre gjatë vitit/2021, janë lëshuar:

Ekstrakt lindjes	14,955
Certifikata të lindjes	4,922
Certifikata te martesës	3,087
Certifikata te vdekjes	1,022
Certifikata te vendbanimit	752
Certifikata e bashkësisë familjare	1,755

Certifikata e gjendjes martesore	461
Certifikata e shtetësisë	101
Vërtetim nga arkiva	205
Gjithsejtë	27,260
Numri i qytetareve qe kane kaluar ne regjistrin qendror	619

Zyrtari i IT

Gjate kësaj periudhë në sektorin e IT janë bërë 80 formatizime dhe janë bërë intervenime tek institucionet komunale shëndetësi, arsimi si dhe shkollat e komunës si dhe janë bërë shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ 60 kyçje në sistem dhe 280 qasje në HRM SYSTEM .

Nga lëmi e servisimit të pajisjeve të IT janë servisuar shumë pajisje duke pasur problem me rrym dhe kanë shkaktuar dëme në pajisje të IT-së janë djegur 16 Poëer suplai (pajisje të furnizimit me rrym) dhe janë përforcuar 30 pc me ram memorie pasi që na është dashur të kalojmë nga sistemet e vjetruara në të avancuara.

Janë bërë incizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejt përderej me teleprezenc në MAPL dhe kam bërë edhe kyçjen në CMS ,

Në faqe postimi i Rregulloreve të cilat nuk kanë qenë të postuara në CMS dhe dizajni imi i ballinës dhe shumë ndryshime në CMS (Contect menagmet System) dhe CSS .

Vlen të cekë se kemi probleme më energji elektrike dhe si pasojë e këtij problemi është djegur serveri Dell Poëer Edge 2950 dhe tani është kthyer në sistem, mirëpo kemi ca probleme pasi që rryma po shkakton shumë probleme dhe po kemi pengesa edhe në punët e përditshme pasi që rryma po i djeg Poëer Suplai .

Aplikacionet komunale në të cilën bëj Administrimin e tyre .

-Intranet, E-arkiva, E-pasuria, Simbnj, SMVP, Domenin Mun.Gov.irk.rks, CMS, Free Balancë Eëb Aplikacion, Sistemin e MPB për riatdhësim, Softëerin për Përkthim donacion nga USAID-i, Menaxhimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej 12 raste, Menaxhimin e softuerit për Hapjen dhe caktimin e orarit të dyerve për hyrje dhe dalje.

- Në QKMF menaxhimin e SISH Aplikacionit

- Në Arsim kemi E-Shkollën i cili është duke u bërë analiza për fillimin dhe implementimin nga MASHT ,në kemi qenë në fazën e testimeve kemi qenë në shkollat ku është bërë testi dhe është bërë që të shikohet se a mundemi të fillojmë implementimin e tyre ,

- Mbrojtja e te Dhënave Personale dhe Konsultimi me Agjencionin për Mbrojtjen e te dhënave Personale për qasje ne te dhënat e kërkuara nga Organizatat dhe shoqëria civile

Njësia për të Drejtat e Njeriut

-Takim me perf. të OSC-es , KFOR-it amerikan, KFOR-it Zviceran, USAID-it, DEMOS-it, Rrjeti i Grupit të Grave, Qendra Rinore, Agjensionit për Barazi Gjinore, takim me përfaqësues të familjeve të zhdukura në komunën tone, Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, takim me një grup grash nga komuniteti Rom, etj. takimet kishin për qëllim bashkëpunimin për vitin 2020

-Monitorimi i seancës së kuvendit komunal, i Komitetit për Politike dhe Financa, Komitetit për komunitete, dhe KKSBB-se.

-pjesëmarrja në takim të rregullt me temën:

1. Gruaja dhe Politika- Rrjeti i Grupit të Grave
2. Kundër dhunës ne familje dhe shoqëri ne kohe pandemie-QENDRA Rinore dhe OSBE
3. Për Personat e pagjetur- ABGJ
4. Fuqizimi ekonomik i gruas, Rrjeti i Grupit të Grave
5. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor- e organizuar nga (USAID)
6. Hartimi i planit te veprimit për mekanizmin kundër dhunës ne familje-OSBE
7. Grat ne pozita udhëheqëse- Rrjeti i Grupit të Grave
8. Lansimi i kalendarit për vitin 2022 me motive kundër familjes, etj.

DREJTORIA E ARSIMIT– RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-31.12.2021

Drejtoria e Arsimit dinamiken e aktiviteteve dhe angazhimeve e ka planifikuar duke u bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2021, përkatësisht prioritet në DA –së që është *ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe të të nxëniet si synimin* parësor, duke mos lënë anash edhe përmirësimin e kushteve tjera e posaçërisht të infrastrukturës shkollore, vazhdimi i kompletimit të kabineteve ,punëtorive dhe mjetet didaktike, ku do të vije në shprehje mësimdhënia dhe mësimnxënia sipas kriterave avansuese të shkollave moderne.

Plani i punës i DA-së është specifik sa i takon aspektit kohor, viti shkollor përkatësisht ai mësimor nuk përputhen me vitin kalendarik, përkatësisht viti shkollor fillon në shtator të vitit paraprak.

Viti i ri shkollor 2021-2022 ,për shkak të pandemisë nga covid -2019 ka filluar më 27 shtator 2021-30.12.2022.Mësimi është zhvilluar sipas Udhëzuesit të përgjithshëm nga MASHTI për organizimin e mësimi për vitin shkollor 2021-2022, në kushtet e pandemisë nga COVID-19.

Gjatë periudhës së parë 2021-2022 me vendim të MASHT-it është punuar edhe të shtunave për zëvendësimin e ditëve të mësimi për muajin shtator. Mësimi u zhvillua me skenarin A, me prezencën fizike të nxënësve në shkollë, falë përgaditjes së objekteve shkollore sipas masave mbrojtëse anti Covid - 19 nga DA-ja dhe përkujdesjes e angazhimit maksimal të stafit arsimor, QKMF-së në Obiliq, prindërve të nxënësve dhe shumë faktorë tjerë.

Në vendbanimin Hadja e re më 31.08.2021 është përruruar objekti i rishkollor, icili është donacion nga Sekretariati i Përgjithshëm i Vakëfve nga Kuvajti nëpërmjet Shoqatës Kuvajtiane për Bami rësidhe është implimentuar nga OJQ "Duart e Bamirësië".

Drejtorja e Arsimit me kohë kapajisur shkollat me librashkollor falas nga MASHTI, pastaj nga DA me material pedagogjik, mjete higjienike, material administrativ. Mjetet mbrojtëse kundër COVID-2019, janë ndarë nga Drejtorja e Arsimit (DA), Ministria e Arsimit, Shkencës,

Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK). Po është bërë Dezinfezioni, Deratizimi dhe Dezinsektimi (DDD) itë gjitha IA para se të fillojë mësimi.

Gjatë vitit 2021 nga DA janë publikuar 6 konkurse, prej tyre një rishpallje. Janë organizuar intervistat për rekrutime, për kandidatë për drejtorë, zëvendës drejtorë e mësimdhënës të kualifikuar dhe janë mbajtur testet me shkrim dhe intervistat me gojë, ku janë zgjedhur 13 kandidatë, prej tyre tre mësimdhënës edhe gjashtë drejtorë dhe dy zëvendës drejtorë, të cilët janë zgjedhur në këto IA:

1. SHFMU "Pandeli Sotiri" Obiliq, vendi i punës drejtor
2. SHFMU "Hasan Prishtina" Milloshevë, vendi i punës drejtor
3. SHFMU "Hasan Prishtina" Milloshevë, vendi i punës, zëvendës drejtor
4. SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" Obiliq, vendi i punës, zëvendës drejtor
5. SHFMU "Migjeni" Siboc, vendi i punës drejtor
6. SHFMU "Fazli Graiçevci" Hade, vendi i punës drejtor
7. SHFMU "Abdurrahmon Gërguri" Dardhishtë, vendi i punës drejtor
8. IP "Rita Jonë" Obiliq, vendi i punës drejtor

Licensimi dhe rilicensimi i mësimdhënësve

Në 10 institucione arsimore me mësim në gjuhën shqipe janë të licensuar 220 mësimdhënës, të rilicensuar janë 11 dhe të pa licensuar 71. Në MASHTI vazhdon procedura për licensim dhe rilicensim, ku do të licensohen edhe 71 mësimdhënës, të pa licensuar.

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë 2021 dhe Testit të Provimit të Maturës Shtetërore 2021

1. Testi i Arritshmërisë 2021 është mbajtur më 21.05.2021, ku kanë marrë pjesë 352 nxënës dhe kalueshmëria në të gjitha shkollat është 54 %

2. Në Gjimnazin "17 Shkurti" në Obiliq kanë hyrë në testin e PMSH, 95 nxënës dhe kalueshmëria në të dy afatet (qershor-gusht) është 95 %

3. Në SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq kanë hyrë në PMSH 200 nxënës, kanë kaluar në të dy afatet (qershor-gusht) 77 apo 38.50%

Afati i qershorit për PMSH është mbajtur 26.06.2021 dhe afati i gushtit 28.08.2021.

- Bazuar në raportet e Drejtorisë së Inspektimit dhe DA-së është rritur niveli i pastërtisë në shkolla.
- Bibliotekat shkollore kanë funksionuar në këto institucione arsimore: "Dr. Ibrahim Rugova" në Obiliq dhe "Ismail Dumoshi" në Obiliq.
- Paisja e të gjitha IA me kamera do të kompletohet gjatë vitit 2022

Ndarja e subvencioneve për vitin shkollor 2021-2022

Për vitin shkollor dhe akademik 2021-2022, me subvencione për bursa dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit janë ndihmuar 998 nxënës e studentë.

- Kompesimet e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të SHFMU dhe SHML, bursa për nxënës me sukses të shkëlqyeshëm të SHML dhe studentë të tri niveleve janë ndarë sipas Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktivitetet jashtëshkollore, Nr.-I-104, datë 31.08.2020.
- Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit janë ndihmuar 750 nxënës, prej tyre 24 nxënës me nevoja të veçanta.
- Për nxënës të SHML me sukses të shkëlqyeshëm janë ndarë 62 bursa
- Për studentë të nivelit baçelor janë ndarë 142 bursa
- Për studentë të nivelit master janë ndarë 43 bursa
- Për studentë të nivelit të doktoraturës është ndarë 1 bursë
- Ekipet për Parandalim, Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve në shkolla për arsimin parauniversitar në IA dhe DA janë funksionale dhe bashkëpunojë mesveti vazhdimisht.
- Aktivitetet arsimore, edukative, kulturore dhe sportive në IA janë reduktuar për shkak të pandemisë nga COVID-19.
- Në të gjitha IA janë regjistruar 426 nxënës, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale.

Nr.	Emri i projektit	Financuar nga	Donatorë
1	Ndërtimi i SHFMU "Fazli Grajqevci " Hadaja e Re		Sekretariatii Përgjithshëm i Vakëf venga Kuvajtinë për mjet Shoqatës Kuvajtanë për Bamirësi dhe është i mplementuar nga OJQ "Duart e Bamirësië"
2	Ndërtimi i aneksit në SHFMU "Naim Frashëri " në Breznicë	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
3	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike dhe aneksit në SHFMU "Pandeli Sotiri " Obiliq	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
4	Renovim (lyrja e brendshme) e SHFMU "Naim Frashëri " në Kozaricë	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
5	Renovim (lyrja e brendshme) e SHFMU "Hasan Prishtina " në Milloshevë	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
6	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Renovim (lyrja e brendshme) e SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova " në Obiliq	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
7	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Renovim (lyrja e brendshme) e SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova " në Mazgit të Poshtëm	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
8	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Renovim (lyrja e brendshme) e SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova " në Mazgit të Epërm	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
9	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Renovim (lyrja e brendshme) e SHFMU "Abdurrahmon Gërguri " në Dardhishtë	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
10	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Renovim (lyrja e brendshme) e SHMLP "Ismail Dumoshi " në Obiliq	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
11	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Renovimi i Gjimnazit "17 Shkurti " në Obiliq	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
12	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve	Drejtoria e Arsimit	

	Renovim(lyrja e brendshme) e SHFMU" Fazli Grajqevci " në Palaj		
13	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Renovim(lyrja e brendshme) e IP"Rrita jonë " në Obiliq	Komuna e Obiliqit	
14	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Drenazhimi i shfmu "Naim Frashëri " Breznicë	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
15	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Paisja e SHFMU" Hasan Prishtina " në Milloshevë me kabinete të shkencave biologji, kimi fizikë dhe kemikale(acide)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
16	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Paisja e SHFMU" Abdurrahmon Gërguri " në Dardhishtë me kabinete të shkencave biologji, kimi fizikë dhe kemikale (acide)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
17	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Paisja e SHFMU" Pandeli Sotiri " në Obiliq me kabinete të shkencave biologji, kimi fizikë dhe kemikalet (acidet)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
18	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Paisja e SHFMU" Naim Frashëri " në Breznicë me kabinete të shkencave biologji, kimi fizikë dhe kemikalet (acidet)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
19	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Paisja e SHFMU" Ismail Dumoshi " në Obiliq me kabinete të shkencave biologji, kimi fizikë dhe kemikalet (acidet)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
20	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Digjitalizimi i shkollave "17 Shkurti " (10 projektorë) dhe "Ismail Dumoshi " në Obiliq (7 projektorë)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	

21	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Lloptopë për Gjimnazin “17 Shkurti “ (10 lloptopë) dhe “Ismail Dumoshi “ në Obiliq (15 lloptopë)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
22	Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve Furnizim me vegla për kopshtari dhe makina pastrimi për IA	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
23	Kompjuter për SHFMU “Abdurrahman Gërguri “ Dardhishtë (8 kompjuterë)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
24	Mirëmbajtja e objekteve komunale – shkollore	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
25	Furnizim me inventar zyrtar, tavolina pune dhe ormana për IA (Kontratë kornizë për furnizime nga APQ)	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
26	Dezinfektimi ,deratizimi dhe dezisektimi i IA (DDD) Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	

- Po ashtu në dhjetor të viti 2021 kanë nisur proceset për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të dy drejtorëve të SHFMU“Dr. Ibrahim Rugova “ në Obiliq dhe “Naim Frashëri “ në Breznicë, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHTI 106/2020 për vlerësimin e performancës së drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar
- Është kryer vlerësimi i punëtorëve të Drejtorisë së Arsimit për vitin 2021 në sistemin e njësisë së burimeve njerëzore (SIMBNJ).Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe regjistrimi i nxënësve në klasën e dhjetë në gjimnaz dhe shkollën profesionale ,janë bërë sipas palnifikimeve të shkollave dhe DA-së . Konkursi për klasë të dhjetë në afatin e parë është realizuar me datat 28.06.2021-30.05.2021 , ndërsa në afatin e dytë më 23.08.2021-25.08.2021

Trajnimet e mësimdhënësve gjatë viti 2021

Edhe pse ishte pandemi nga COVID -19 kanë vazhduar disa trajnime,ku janë trajnuar 15 edukatorë dhe 103 mësimdhënës dhe kanë përfunduar këto trajnime: Përgatitja për klasën përgatitore dhe arsimin fillor në zbatimin e kurrikulës së re ;Përgatitja e edukatoreve parafillor për përkrahjen dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitetit ;Plani Individual i Arsimit (PIA);Prodhim material didaktik;Menaxhimi istresit tek nxënësit pas pandemisë COVID-19;Mësimdhënia në distancë;metodologjia me nxënësin në qendër ;PIA dhe mënyra e zbatimit të tij me nxënësit me

nevoja të veçanta dhe trajnimi të drejtat e fëmijëve. Po ashtu me trajnimin për të drejtat e fëmijëve janë kanë marrë titullin trajner tre mësimdhënës dhe një zyrtarë nga Drejtoria e Arsimit, të cilët më pas kanë trajnuar edhe 19 mësimdhënës nga të gjitha IA.

Gjatë vitit 2021 është bërë edhe vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve të 18 mësimdhënësve, të cilët kanë ndjekur trajnimin përgatitja për klasën përgatitore dhe arsimin fillor në zbatimin e kurrikulës së re.

Kompensimi i obligimeve për ish- mësimdhënësit e pensionuar

Është bërë kompensimi i obligimeve sipas të gjitha kontratave kolektive, për mësimdhënësit e pensionuar, në aspektin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse.

27	Dezinfektues dhe masaka për shkolla		Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
28	Maska për institucionet arsimore		Forcat e Sigurisë së Kosovës 5.000.00 copë
29	Furnizim me dru dhe pelet për IA	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
30	Furnizim me derivate për shkolla (naftë dhe benzin) për agregatë	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
31	Vendosja e kamerave në SHFMU "Hasan Prishtina" në Milloshevë	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	OSBE
32	Vendosja e kamerave në SHMLP "Hasan Tahsini" në Obiliq dhe "17 shkurti" në Obiliq	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
33	Bartja e nxënësve në relacionet Shpitullë – Gabovc, Hade – Palaj dhe anasjelltas	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
34	Blerja e kalldajës për ngrohje në SHFMU "Fazli Graiçevci" PNF Palaj	Komuna e Obiliqit Drejtoria e Arsimit	
35	Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në fshatin		Bashkimi Evropian Projekti është duke u

	Mazgit i Poshtëm		ndërtuar
--	------------------	--	----------

Projektet kapitale të DA të realizuara, dhe në vazhdim gjatë vitit 2021

Komuna	Shkollë	Shqiptarë		Serbë		Ashtkali një		Romë		Gjithsej
		Meshkuj	Femër	Meshkuj	Femër	Meshkuj	Femër	Femër	Gjithsej	
Obiliq	RritaJonë	25	36			0	0	0	0	61
	NaimFrashëri	103	98			0	0	0	0	201
	NaimFrashëri 1	35	39			0	0	0	0	74
	AbdurrahmonGërguri	68	59			0	0	0	0	127
	Migjeni	88	65			0	0	0	0	153
	Migjeni 2	18	23			0	0	0	0	41
	Hasan Prishtina	290	307			14	7	0	0	618
	Hasan Prishtina 1	45	37			0	0	0	0	82
	Ismail Dumoshi	263	100			3	0	0	0	366
	17 Shkurti	104	202			0	0	0	0	306
	FazliGraçevci	7	7			0	0	0	0	14
	FazliGraçevci 1	48	49			0	0	0	0	97
	FazliGraçevci 2	25	27			8	8	0	0	68

	117	100	217				7	1	8	0	0	0	225
PandeliSotiri													
PandeliSotiri 1	27	25	52				63	49	112	2	0	2	166
Dr. Ibrahim													
Rugova	484	475	959				3	4	7	0	0	0	966
Dr. Ibrahim													
Rugova 1	84	72	156				0	0	0	0	0	0	156
Dr. Ibrahim													
Rugova 2	143	112	255				0	0	0	0	0	0	255
Sveti													
Sava(sh.Fillore)				36	45	81				98	10	108	189
Sveti													
Sava(shm.mjekësi)				33	24	57				4	1	5	62
Sveti													
Sava(shm.ekonomi)				8	5	13				16	1	17	30
Milan Rakiq				67	35	102				0	0	0	102
DosidejObradovi													
q				28	25	53				0	0	0	53
Gjithsej	1974	1833	3807	172	134	306	98	69	167	120	12	132	4412

Numri i nxënësve në institucionet arsimore gjatë viti shkollor 2021-202

Të dhëna për zyrtarë publik në arsim ,dhjetor 2021

Institucioni: ARSIMI																		
	Totali	Struktura kualifikuese				Struktura etnike							Struktura gjinore		personat me af-tesi te kufizuar			
		shk. e shk. e lartmesmerik. fillo	shk. e lartmesmerik. fillo	shk. e lartmesmerik. fillo	shk. e lartmesmerik. fillo	s	b	t	g	a	e	r	ë	tjet	m	f	m	f
DKA	350	330	20	0	0	329	21			0				100	249	1		
nepunes i shërbimit publik		1	1	49	5	43	8			5				42	14			
nepunes ad. dhe mbeshitetes	56																	
Legjenda:																		
Struktura etnike, shkurtesat: sh=shqiptar; s=serb; b=bosnjak; t=turq; g=goran; a=ashkalinje; e=egjiptian; r=rom; t=tjerë; m=meshkuj; f=femra																		
Verejtje:																		
Në këto të dhëna postet politike (kryetari dhe nenkryetari i komunes), duhet te perfishihen ne kolonen ne fund te formularit.																		

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë																			
Suksesi i nxënësve në fund të periodes së parë 2021-2022																			
Arsimi fillor (1-5)																			
Komuna																			
OBILIQ																			
Klasa	Nr. parale	Nr. nxënë	Suksesi pozitiv		Mirë	Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		e nota negative q		Numri i mungesave							
			Nr	%		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Të arsyë	Të paars						
1	18	308	221	71.75	53	17.21	29	9.42	4	1.30	307	99.68	0	1	0.32	2861	327	3188	
2	18	297	193	64.98	52	17.51	38	12.79	13	4.38	296	99.66	0	1	0.34	3934	404	4338	
3	19	323	184	56.97	67	20.12	49	15.17	12	3.72	312	96.59	11	3.41	0	4330	231	4561	
4	19	364	192	52.75	88	24.18	57	16.48	17	4.67	354	97.25	8	2.20	2	555	5241	1249	6490
5	18	320	165	51.56	92	29.38	43	13.44	10	4.06	310	96.88	10	3.13	0	4670	1007	5677	
Σ	92	1612	955	59.24	352	21.84	216	13.59	56	3.66	1579	97.95	29	1.80	4	0.25	21036	3218	24254
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë																			
Suksesi i nxënësve në fund të periodes së parë 2021-2022																			
Arsimi i mesëm i ulët (6-9)																			
Komuna																			
OBILIQ																			
Klasa	Nr. parale	Nr. nxënë	Suksesi pozitiv		Mirë	Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		e nota negative q		Numri i mungesave							
			Nr	%		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Të arsyë	Të paars						
6	19	324	71	21.91	67	20.68	67	20.68	15	4.63	204	62.96	103	31.79	1	0.31	4374	964	5338
7	19	337	74	21.96	94	24.93	51	15.13	13	1.78	232	68.84	104	30.86	1	0.30	4962	664	5626
8	19	304	70	23.03	68	22.04	63	20.72	7	2.30	207	68.09	96	31.58		4251	945	5196	
9	19	341	78	22.87	68	19.94	62	18.18	10	2.93	218	63.93	121	35.48	2	0.59	5537	2151	7688
Σ	76	1306	293	22.43	297	21.90	243	18.61	45	2.91	861	65.93	424	32.47	4	0.31	19124	4724	23848

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë																			
Suksesi i nxënësve në fund të periodes së parë 2021-2022																			
Arsimi i mesëm i lartë (10-12)																			
Komuna _____ OBILIQ																			
Klasa	Nr. parale	Nr. nxënës	Suksesi pozitiv		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Gjithsej me nota		Të pa notuar		Numri i mungesave		
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Të arsyet	Të paarsyesh	Gjithsej
10	11	222	20	9.01	42	18.47	29	13.06	4	1.80	94	42.34	119	53.60	8	3.60	1207	824	2031
11	11	223	22	9.87	36	16.14	26	11.66	9	4.04	93	41.70	124	55.61	6	2.69	1063	1350	2413
12	10	220	25	11.36	19	8.64	21	9.55	9	4.09	74	33.64	138	63.18	8	3.64	1849	975	2824
Σ	32	665	67	10.08	96	14.44	76	11.43	22	3.31	261	39.25	382	57.44	22	3.31	4119	3149	7268

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS – RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-31.12.2021

Raporti i punës për periudhën 01. 01.2021 – 31.12.2021

Drejtoria e Infrastrukturës gjatë kësaj periudhe kohore ju kemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve në bazë të kërkesave kemi punuar paramasat paralogaritë projektet për përmirësimin e kushteve të jetës së tyre.

Kemi dërguar shkresa për institucione të ndryshme, kemi realizuar projekte në bazë të kërkesave të drejtorive tjera komunale.

Jemi duke menaxhuar kontrata si për DIL ashtu edhe për drejtoritë tjera kërkuese të komunës. Kemi realizuar projekte për donatorë, marrëveshje me pronarë privat rreth investimeve kapitale dhe përgatitja e dokumentacionit për evidentim në kadastër për evidentimin e parcelave në të cilën planifikohet shkitirja e rrjeteve të kanalizimit ujësjellësit dhe rrugëve

Cdo projekt i cili ka ardhur nga kompani projektuese në të cilën kemi dhe kontratë e kemi kontrolluar para se të shpallet në tender, për arsye të mos kemi probleme gjatë ekzekutimit etj.

PROJEKTET TË CILAT JANË PUNUAR NGA NDREJTORIA E DIL-it për drejtoritë komunale:

Për drejtinë e DIL-it
1. Ndertimi I Urës Automobilistike në Komune e Obiliqit, Fshati Grabovc, Rruga Bajram Mjeku
2. Ndërtimi I Urës Këmbësorike Metalike ne Grabovc/Rr. Bajram Mjeku
3. Ndërtimi I Brezit të gjelbërt Kosova A(trotuari, shtigjet për biciklista, ndricimi dhe kanalizimi atmosferik)
4. Diskolimi I Gypit të ujitjes së Ibër Lepencit
5. Trotuari dhe Ndricimi Obiliq-Plemetinë
6. Riparimi I rrugës Sabedin Pllana-Lajthishtë
7. Plemetinë Rr. Sokoli seg.1 L=2124m B=4
8. Rrugë që janë duke u punuar ne fshatin Grabovc
9.Objekti për pastrimin e Kufomave P+NK
10.Sistemi I Ujitjes pik pik për brezin e gjelbërt Kosova A
11.Ndërtimi I shtratit të prockës në rrugën Mbretëresha Teutë
12.Ndërtimi I Urës në rrugës Roga Graboc
13.Ndërtimi I krojeve dhe kanali I ujit për Mullinjët në fsh Graboc

14.Ndërtimi I objektit për parking Mbitoksor.
15. Ndricimi Plemetin Obiliq
16. Ndricimi Publik për teritorin e Obiliqit
17. Kyqja e Bibliotekës
18. Paisjet elektrike për shtëpinë e shëndetit
19.Raportet për Efiqencë
20. Graboc vazhdimi I Rr. Islam Mjeku L=330m, B=3m
21. Lajthishtë Rr. Shtabi I UCK-së seg 1 L=120m B=3m
22. Llazarevë Rr. Viktoria seg 1 L=210m B=3.5m
23.Llazarevë Rr.Viktoria seg 2 L=140m B=3.5m
24. Bakshi Rr. Ushtarët e UCK-së seg 1 L=121m B=3.5m
25. Paramasa dhe paralogaria e fushave sportive ne fsh. Breznice Grabovc, Sibovc, Palaj, Dardhishte dhe Hade e re
26. Paramasa dhe paralogaria e objektit te Sheshi Deshmoret e Qytetit
27. Hartimi I proejktit dhe paramasa per konstruksionin metalik per mbulesen e parkingjeve ne QKMF-Obiliq
28. Asfaltimi I rrugëve rurale ne fshatin Raskove-Millosheve Pjesa e dytë
29. Punimi I projektit për parkun në Breznicë
30. Punimi I projektit për Parkun në Graboc
31. Punimi I projektit për renovimin e Shkollave në Obiliq
32. Punimi I projektit për ngjyrosjen e Gjimnazit dhe Shkollës Teknike
33. Punimi I projektit për këndin e lojërave Obiliq
34. Punimi I projektit për parkingun dhe mbulojën e parkinut në QKMF
35. Punimi I projektit për inventarin e shtëpive të komunitetit në Mazgit,Dardhishtë,Sibovc
36. Punimi I projektit për Raftet e Arhivës
37. Punimi I projektit për restaurimin e Xhamisë në fshatin Hamidi
38. Punimi I projektit për restaurimin e objektit te sheshi në obiliq
39. Punimi I projektit për rindërtimin e parkut para banesave sociale në Obiliq
40.Puna me Komisionin e vlerësimit të ofertave – 30 gjithësejt
40.Ndërtimi I objekteve të komunitetit në fshatratë Breznicë dhe Kozaricë

41.Mirëmbajtja e Intranetit

42.Pranimi ,shqyrtimi dhe përgjigja në kërkesat e palëve -144 gjithësejt

PROJEKTET TË CILAT JANË EKZEKUTUAR DHE VAZHDOJNË

Titulli i kontratës (i plotë)	Numri i prokurimit (e-prokurim)	Vlera gjithsej e kontratës	Afati i kontrates (në muaj)	Vlera e mbetur e kontratës	Afati i mbetur i kontrates (në muaj)	Shënime
Asfaltimi I rrugëve në Milloshevë- pjesa e parë	Nr.Prok: 614/21/022/521					eshte perfundu
Asfaltimi dhe kubezimi I rrugeve ne Obiliq pjesa e tretë	Nr.Prok: OB614- 21-311-5-2-1					eshte perfundu
Ndërtimi I trotuarit dhe Ndricimi ne Plemetine	Nr.Prok: 614/21/032/521					eshte perfundu
Rregullimi I segmenteve te rruges Halit Bici dhe Dita e Flamurit me seg(pjesa e njembedhete)	Nr.Prok: 614/21/070/521	60,757.71	1Vite (365 dite)	35,757.71	Plani dinamik eshte 365 dite pra 1vjeqare	Per ket vit eshte permbyllur projekti pasi nuk kemi buxhet te parapare me shume vetem 25,000.00 ku dhe jane perfunaur punet per ket vlere

"Asfaltimi i rrugëve ne fsh Milloshve Sibofc Lajthishte (pjesa e dhjetë)"	614 21 069 521	40,947.43 €	60 dite pune	5,086.62 €		Vazhdon
"Asfaltimi i rrugëve ne fsh Milloshve Sibofc Lajthishte (pjesa e dhjetë)"ANEKS KONTRATA	614 21 069/5-1 535	2,554.49€	10 dite			Perfunduar
" Punimi i kabinave per trafostacione"	OB 614 21 044 521	19,347.20 €	20 dite	2,516.00		Vazhdon
" Punimi i kabinave per trafostacione" ANEKS KONTRATA	OB 614 21 044/5-1 535	1,934.72€	10 dite			Perfunduar

"Ndërtimi i Sheshit Adem Preniqi"	614 20 050 511	989,026.00 €	9muaj			Përfunduar
"NDËRTIMI I SHESHIT TË QYTETIT NË OBILIQ"	614 18 057 511	1,199,879.60€	24 muaj			Përfunduar
"Koogjenerimi-faza e parë e ndërtimit të sistemit të koogjenerimit për ngrohjen e qytetit të Obiliqit"	614 20 047 511	917,917.91€	12 muaj			vazhdon
"Rikonstruimi i banesave sociale-Rikonstruimi i fasadës dhe lokaleve per objektin kolektiv"	614 20 057 521	165,450.59 €	24 muaj			Përfunduar
"Asfaltimi i rrugëve në fsh. Dardhishtë & Mazgit".	614 19 027 521	447,833.03 €	12 muaj			Përfunduar
"Asfaltimi i rrug.Faruk Rama; Fehmi Agani; Tabat e Llapshiticës seg.1 dhe 2".	614 19 030 521	335,184.39 €	12 muaj			Përfunduar

Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq-Riparimi i rrugës Sabedin Pllana Lajtishtë (pjesa e katërt	614 21 041 521	37,865.50 €	40 dite			Përfunduar
“Ndërtimi i brezit të gjelbër Kosova (A)”	614 21 033 521	326,652.20€	90 dite			vazhdon
Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq-Asfaltimi i rrugëve Islam Mjeku Graboc dhe rr shtabi i uçk-së seg 1 Lajtishtë (pjesa e pestë)	614 21 045 521	23,727.74€	40 dite			Përfunduar
Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq –Asfaltimi i rrugëve në fshatin Llazarevë dhe Bakshi (Pjesa e shtatë)	614 21 055 521	27,992.49€	50 dite			Përfunduar
Rregullimi i rrugëve me kubëza te familja Rama pjesa e tetë	614 21 063 521	24,222.15€	50 dite			Përfunduar
Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq segmentet e rrugës Afrim Zhitija - (Pjesa e nëntë)	614 21 067 521	85,155.83€	80 dite			Vazhdon

Rregullimi i rrugëve në Obiliq dhe Mazgit - (pjesa e trembedhjetë)	614 21 071 521	23,906.65€	60 dite			Vazhdon
--	----------------	------------	---------	--	--	---------

Titulli i kontratës (i plotë)	Numri i prokurimit (e-prokurim)	Vlera gjithsej e kontratës	Afati i kontratës (në muaj)	Vlera e mbetur e kontratës	Afati i mbetur i kontratës (në muaj)	Shënime
Asfaltimi i rrugëve rurale në fshatin Milloshevë-Raskovë-Pjesa e dytë	614 21 021 521	87,613.40 €	3	571.96 €	0	Projekti është përfunduar kanë mbetur edhe 571.96€
Rregullimi i kanalizimit në Obiliq-Kanalizimi Atmosferik dhe Fekal (pjesa e pare)	614 21 040 521	71,213.82 €	2	15,186.21 €	0	Është bërë shkputja e kontratës
Rregulimi i fushave sportive në fshatin: Breznicë, Siboc, Graboc dhe Palaj	614-21-013-521	143,552.91 €	4	32,017.69 €	0	Është bërë shkputja e kontratës
Pastrimi i shtratit të lumit nga fsh.Kozaricë, Breznicë, Stanovc I Eperm dhe Stanovc I Poshtëm	644 20 088 521	49,280.00 €	24	3,852.00 €	0	Projekti ka përfunduar Bashk financim me KK Vushtrris
Ndërtimi i Urës Këmbesorike Metalike ne Komunen e Obiliqit/Fshati Grabovc	614 21 029 521	28,881.89 €	3		0	Perfunduar

Rrethoja e shkollës në Plemetin	OB-IOM-CO	3,000.00 €			0	Ka Perfunduar
Renovimi i objekteve në QKMF,AMF dhe QMF	614 - 21 – 056 - 521	14,956.98 €	2	4.72 €	0	Ka përfunduar
Ndërtimi i urës në fshatin Graboc Rr,Bajram Mjeku	614 - 21 – 010 - 521	133,830.29 €	3	3,144.91 €	0	Projekti ka përfunduar mbetja është 3,144.91€
Rregullimi i Parkingjeve	614 - 21 – 057 - 521	28,798.03 €			0	Ka përfunduar
Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq-Asfaltimi i rrugëve në Plemetin, lagjja Bregagji (Pjesa e gjashtë)	614 21 053 521	53,260.11 €	2	- €	0	Projekti ka përfunduar
Dislokimi i gypit të ujitjes te objekti i kogjenerimit	614 21 037 521	55,555.00 €	1	15,053.15 €	0	Shkputja e kontratës
Ndërtimi i urës në fshatin Graboc Rr,Bajram Mjeku	614 - 21 – 010 - 521	133,830.29 €	3	3,144.91 €	0	Projekti ka përfunduar mbetja është 3,144.91€
Ndertimi I disa pjesve te kanalizimit ne fshatin Breznicë- Kozaricë (pjesa e dytë)	614 21 065 521	52,403.19 €	3	- €	0	Projekti ka përfunduar

**DREJTORIA E SHËNDETËSIS DHE MIRËQENIES SOCIALE– RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-
31.12.2021**

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë vitit 2021 në kuadër të përgjegjësisve të veta ka kryer punë dhe detyra të shumta duke përfshirë edhe menaxhimin me situatën e krijuar me Pandeminë COVID 19.

Janë realizuar takime të shumta me MSH, IKSHP, OBSH, Kolegjiun e Shëndetësisë. Janë diskutuar tema nga më të ndryshmet si: menaxhimi I Pandemisë, fillimi I vaksinimit, sigurimi I testeve antigjene, trajnimi I ekipeve për vaksinimin e qytetarëve me vaksinën kundër virusit COVID 19.

Kujdesi Shëndetësor I Qasshëm dhe Cilësor projekt i vazhduar i bashkëpunimit ku ne si Komunë jemi në mesin e dymbëdhjetë Komunave të përzgjedhura nga kjo OJQ. Projekti implementohet nga Sëiss TPH and Save the Children dhe përfitimet nga ky bashkëpunim janë të shumfishta si: ngritja e kapaciteteve njerëzore në ofrimin e shërbimit cilësor shëndetësorë.

Është lidhur marrëveshje bashkëpunimi në mes Kryetarit të Komunës z.Xhafer Gashi dhe Islamic Relief Kosova. Ky bashkëpunim avacon ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarët tanë përmes angazhimit të 11 profesionistëve shëndetësorë në projektet: “Kujdesi shtëpiak për lehonat, kujdesi për personat e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuar”.

Takime të rregulta me KFOR-in, në fokus ngritja e cilësisë shëndetësore me prioritet të veçantë në shërbimin e emergjencës si dhe mbështetje në ligjerata dhe trajnime.

Vazhdojnë takimet me Fondacionin e Katarit, po ashtu janë mbajtur takime me Fondacionin e Kuvajtit dhe OJQ-në “Qëndresa Kosovare” lidhur me donacionet e mundshme.

Gjatë gjithë kohës së Pandemisë COVID 19, me përkushtim I gjithë personeli shëndetësorë si dhe stafi mbështetës kanë kryer detyrat dhe misionin e vet duke ofruar ndihmë mjekësore të gjithë pacientëve në kushte ambulatore, teren, në shtëpi dhe në çdo vend tjetër ku është kërkuar, dhe sipas nevojës transportin e pacientëve në klinikat e QKUK-së dhe anasjelltas.

Që nga fillimi I Pandemisë e deri më sot janë testuar 5343 persona, nga ta:

2491 - Kanë rezultuar pozitiv

2852 – Kanë rezultuar negativ

2426 - Të shëruar

3 – Raste aktive

62 – Të vdekur

Të gjitha familjet e vetëizoluara janë kontaktuar nga Epidemiologia jonë. Janë rekomanduar për masat e vetëizolimit si dhe ju janë përsëritur masat mbrojtëse të cilat duhen të ju përmbahen po ashtu të kërkojnë në mënyrë urgjente ndihmë mjekësore nëse kanë ndonjë shqetësim apo përkeqësim të gjendjes shëndetësore. Po ashtu që nga rasti i parë i paraqitur pozitiv me COVID 19 është ofruar mbështetje logjistike për të gjitha familjet e vetëizoluara nga Kryetari i Komunës së Obiliqit.

Me arritjen e vaksinave kundër infeksionit me virusin COVID 19, më dt.29.03.2021 ekipi mjekësor i përbërë nga një mjek dhe dy teknik, qysh në orët e mëngjesit kanë qenë prezent në sallën “1 Tetori” në Prishtinë, ku pritej të fillonte procesi i vaksinimit.

Ekipi i QKMF-së Obiliq, nga komuniteti i vaksinimit është caktuar si ekip mobil i cili vaksinon personelin shëndetësorë në klinika.

Vaksinimi është realizuar sipas planit të vaksinimit të komunitetit për vaksinim.

Vaksinimi në komunën e Obiliqit filloi më dt. 07.04.2021, fillimisht me vaksinën AstraZeneca e më vonë edhe me Pfaizer.

Kategoritë e lejuara nga komiteti i vaksinimit për teritorin e Kosovës filloi me personelin shëndetësorë duke vazhduar me kategoritë prioritare të caktuara nga komiteti për imunizim.

Me kërkesë të MSH dhe IKSHPK-së, është përpiluar lista me të dhënat e personelit shëndetësorë për vaksinim kundër COVID-19, me të sëmurët kronik dhe individët mbi moshën 80 vjeçare.

Sasia e vaksinave të dhëna nga 07.04.2021 deri më 31.12.2021 në QKMF-Obiliq:

- AstraZeneca-----doza e parë =1457
- Astra Zeneca-----doza e dytë =1381
- Pfaizer-----doza e parë =10974
- Pfaizer -----doza e dytë =9795
- Pfaizer-----doza e tretë =171

Me vaksinim do të vazhdohet edhe në vitin e ardhshëm, deri në përmbushjen e objektivave të përcaktuara për imunizim të popullatës në masë, sipas rekomandimeve nga Komiteti për imunizim.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Ka vazhduar organizimi I punës pa ndërprerje në ambulantën COVID 19 për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të pacientëve të rezultuar pozitiv me virusin Corona ku është zbatuar orari I plotë. Përkundër mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit shëndetësorë, organizimi I tillë përballojë nevojat dhe kërkesat për zbatimin e rekomandimeve në parandalimin dhe frenimin e përhapjes së virusit COVID-19.

Njoftim I vazhdueshëm rreth riorganizimit dhe rrezikshmërisë së përhapjes së virusit COVID19.

Shërbime shëndetësore, cilësore 24/7.

Gadishmëri e organizuar në ekipe mjekësore për transportimin e pacientëve të dyshuar dhe pozitiv me COVID 19.

Sigurimi I autoambulancës vetëm për rastet e infektuara me virus.

Mbështetje dhe asistencë me ekipe mjekësore në Aeroportin e Prishtinës.

Vizita të vazhdueshme monitoruese të gjitha njësive të QKMF-së.

Furnizim me material shpenzues mjekësor.

Furnizim me material për shërbime laboratorike.

Furnizim me material administrativ shëndetësorë.

Furnizimi me pako ushqimore dhe higjenike për familjet e izoluara si dhe familjet në nevojë.

Pranimi I testeve antigjene në QKMF.

Kordinimi I aktiviteteve në mes qendrës së vaksinimit dhe IKSHPK-së për fillimin e procesit të vaksinimit.

Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF-së.

Përgaditja e Qendrës së Vaksinimit në shtëpinë e kulturës“Xhavit Haziri” për fillimin e vaksinimit kundër virusit COVID 19.

Vaksinimi I rregullt për fëmijët e grup moshave të caktuara sipas kalendarit të vaksinimit si dhe vaksinimi I nxënësve.

Identifikimi I nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së.

Identifikimi I nevojave për lehtësimin e punës së përditëshme të personelit.

Dezinfektimi I QKMF-së, QMF, AMF dhe autoambulancave në baza ditore (deri tri herë në ditë).

Ndërprerja e pushimeve vjetore si dhe rritja e kritereve për pushime mjekësore.

Përgaditje teknike dhe administrative për hapjen e konkurseve.

Përgaditje e specifikave për procedure prokurimi.

Përmirësimi I infrastrukturës së institucioneve të KPSH.

Inventarizimi.

Ekipet mjekësore të QKMF-së kanë asistuar dhe mbështetur aktivitetet kulturo-sportive.

Takime të përditëshme me qytetarë.

Janë kryer punët e përditëshme tekniko- administrative (fatura, kërkesa).

Komuna e Obiliqit në bashkëpunim me Qendrën Për Punë Sociale ndihmon me pako ushqimore dhe higjienike 300 familje në nevojë.

UNICEF përmes Ballkan Sunflooërs në bashkëpunim me QKMF-në, bën shpërndarjen e 242 pakove për fëmijë me kushte të rënda ekonomike.

Më 100 pako ushqimore dhe higjienike u mbështeten familjet në nevojë nga Poligoni i Shenjëtarisë "Katana", Obiliq.

Fondacioni "Freskia" ndihmon familjet në nevojë me 100 pako ushqimore dhe higjienike.

Bashkëatdhetari z.Ujup Preniqi, ndihmon me 40 pako ushqimore dhe higjienike familjet në nevojë.

Ambasada e Emirateve të Bashkuara Arabe, ndihmon 85 familje me pako ushqimore dhe higjienike.

UN ndihmon me 80 pako ushqimore dhe 80 higjienike familjet në nevojë.

Në bazë të kompetencave që dalin nga ligji nr.03/048, ligjit për shërbime sociale dhe familjare nr.02/L-17, Statutit të Komunës nr.01/34, konformë rregullorës nr.108, DSHMS shpallë Thirrje Publike për blerjen e këtyre shërbimeve të veqanta:

- I. Shërbime sociale dhe familjare për fëmijët pa përkujdesje prindërore
- II. Shërbime për personat me aftësi të kufizuar
- III. Shërbime për pensionistët
- IV. Qendra për mbrojtjen e gruas dhe fëmijës.

Vlera për blerjen e këtyre shërbimeve në total është 12,000.00 €.

Pranimi i kërkesave për nevoja sociale dhe shëndetësore:

Janë pranuar 336 kërkesa nga palët nevojtare.

254 prej tyre janë të realizuara,

82 të refuzuara.

268 kërkesa të realizuara për Lehonat deri më 30.11.2021.

Pas kësaj date janë pranuar edhe 26 kërkesa për subvencionimin e Lehonave të cilat do të realizohen në vitin 2022.

Gjatë vitit 2021 nga DSHMS janë inicuar procedurat e prokurimit për projekte dhe shërbime tjera për nevojat e QKMF-së dhe QPS:

1- Renovimi I Objekteve të QKMF, QMF, AMF, QPS,

Shtëpia e Pleqëve-----14,952.26 €

2- Pajisje mjekësore për QKMF-në-----26,980.00 €

3- Inventar për QKMF dhe njësitë e sajë-----10,000.00€.

4- Blerja e autoambulancave/ veturave-----19,175.00€.

5- Pajisje elektrike QKMF, QMF dhe AMF-----10,000.00€

Raporti Vjetor - 2021

MALLRA DHE SHERBIME	Shpenzim
Material gjinekologjik-radiologjik	4,400.00
Material ampular	13,901.40
Material laboratorik	19,922.00
Material administrativ	1,000.00
Furnizim me material stomatologjik	5,942.00
Karburante për vetura	7,889.37
Regjistrimi I automjetit	515.69
Interneti	113.41
Sherbime me aparat fotokopjues	161.05
Furnizim me pako ushqimore	14,994.00
Mirëmbajtja e objekteve	9,534.19
Vendime gjyqësore- paga jubilare	29,745.35
Avans për para të imta	1,000.00
Paisje elektrike QKMF,AMF dhe QMF	10,000.00
Blerja e autoambulancave	19,175.00
Inventar për QKMF	

	10,000.00
Paisje mjekësore për QKMF	42,625.00
Renovimi I objekteve në QKMF,AMF dhe QMF	20,000.00
Dezinfektim Dezinfektim Deraitizim hapsinor	33,246.98
Furnizim me pelet dhe dru	15,000.00
Furnizim me regjistër të vaksinimit	980.00

KOMUNALI	
Rrymë elektrike	20,543.93
Ujë	2,376.82
Telefon	1,710.69

QKMF

Gjatë kësaj kohe Këshilli Drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, disiplinës, orarit të punës etj.

Në QKMF gjatë kësaj periudhe janë trajtuar një numër i madh i pacientëve dhe janë ofruar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve (shif tabelën)

NUMRI I PACIENTËVE DHE NUMRI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Nr	QENDRA KRYESORE E MJEKËSIS FAMILJARE	Numri i pacientëve	Numri i shërbimeve mjekësore
1.	QKMF OBILIQ	124292	280882
2.	QMF MILLOSHEVË	6999	13988
3.	QMF PLEMETIN	1080	5102
4.	AMF SIBOC	2597	7726
5.	AMF BREZNICË	1933	4096
6.	AMF B.MOFC	2528	8458
	TOTALI:	139429	320252

JANAR- DHJETOR 2021

	QKMF -Obiliq		Nr. i referimeve <u>PËR KONSULTI ME</u> në kujdesin tretësor	Nr. i referimeve <u>NË DIAGNOS TIKËN</u> e kujdesit tretësor	Nr i referimeve në <u>QENDRËN EMERGJENTE</u>	Gjithsej Udhëzime për Kujdesin tretësor	Numri i përgjithshëm i vizitave mjekësore	Përqindja (%) e të referuarve në kujdesin tretësor
	Njësia	Departamenti						
1	QKMF Obiliq	Mjekësi Familjare	4598	405	40	5043	40962	12.3%
2	QKMF Obiliq	Emergjencia	187	24	1132	1343	12256	10.9%
3	QKMF Obiliq	Pediatria	1577	186	0	1763	9744	18 %
4	QKMF Obiliq	Gjinekologjia	377	9	0	386	1736	22.2%
5	QKMF Obiliq	Shëndetitoral	104	376	0	480	3745	12.8%
5	QMF Milloshevë	Mjekësi Familjare	649	84	197	930	6515	14.2%
7	QMF Milloshevë	Shëndetitoral	5	51	0	56	486	11.5%
3	QMF Plemetin	Mjekësi familjare	9	13	0	22	1507	0.1 %
9	AMF Breznicë	Mjekësi Familjare	237	108	24	369	1933	19 %

10	AMF Siboc	Mjekësi Familjare	245	51	7	303	2597	11.6 %
11	AMF.Ba Moc	Mjekësi familjare	565	155	0	720	2528	28.4 %
			8553	1462	1400	11415	84009	13.5 %

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për Sëmundjet masive jo infektive për muajin JANAR-DHJETOR 2021

Të sëmundjeve masive jo infektive,

F00,F04,F05 ,F09,F20,F30,F31,F32.3,F33,F22,F29,F84,G71(shëndetit mental)

2.E10-E14,(sëmundjes së sheqerit)

3.I00-.I02,I20,I21,I24,I25(sëmundjeve kardiovaskulare)

4.N05(nefropatit)N03,N04,N05,N10,N18

5.J42,J45,J47 ,(sistemit respirator)

6.D65-D69,C-(sëmundje malinje),

Sëmundjet	Numri
I10	67
I20, I21, I24, I25	3
E10-E14	30
J42, J45, J47	4
N03, N04, N05, N10, N18	0

F00-F48	2
Sëmundjet malinje	7
Numri i refrimeve në nivelin sekondar	8651
Numri i referimeve në diagnostiko	1462
Totali i pacientëve	84009

Gjatëmuajit janë dorëzuar gjithësej Fletëparaqitje:

Sëmundje masovike jo ngjitëse – 112

Sëmundje malinje – 8

Raportimet ditore

1. Sëmundjet e traktit Respirator 13059
2. Sëmundjet e qarkullimit të gjakut 6658

RAPORT I NUMRIT TE PACIENTEVE SIPAS SHERBIMIT

NGA ËEB APLIKCIONI

QKMF-OBILIQ

Njesi-QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Gjinekologjia	1580
Laboratori	3660
Mjekësia Familjare	34149
Pediatria	6848
Rentgen	2744
Shëndeti Oral	3332
Shërbimi Emergjent	4054
	56367

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA NË QKMF

DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

SEKTORI I MJEKËSISË FAMILJARE		
1.	Numri i pacientëve të vizituar	40962
	Totali i shërbimeve	69350

KËSHILLIMORJA PËR PERSONAT ME DIABET DHE HIPERTENSION		
1.	Nr. i pacientëve	1257
	Totali i shërbimeve	2421

VIZITAT SHTËPIAKE PËR NËNËN DHE FËMIUN DERI NË TRI VJET (Qakime virtuale përmes		
1.	Nr. i vizitave në shtëpi	529
2.	Nr i fëmijëve të përfshirë në vizitë	264
3.	Nr i shtatëzënave të përfshirë në vizitë	363

4.	Nr i rasteve të Komunitetit Rom Ashkalinjë të përfshirë në vizitë	75
5.	Puna në grupe “Klasat për Nëna”	366

SEKTORI I KUJDESIT EMERGJENT

KUJDESI EMERGJENT		
1.	Numri i pacientëve të vizituar	12256
	Totali i shërbimeve	33766

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK

NJESIA E VAKSINIMIT DHE IMUNIZIMIT		
1.	Numri i shërbimeve	57.526
	Numri i pacientëve në qendër dhe teren	24.749

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

--	--	--

	SHËNDETI ORAL	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	3206
	Totali i shërbimeve	12489

SEKTORI KONSULTATIV

	NJËSIA E PEDIATRISË	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	9744
	Totali i shërbimeve	11381

	NJËSIA E GJINEKOLOGJISË	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1736
	Totali i shërbimeve	3226

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

	LABORATORI	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	14964

	Totali i analizave të punuara	73950
--	--------------------------------------	--------------

	RTG	
	Totali i shërbimeve	6131

	BARNATORJA NË QKMF		
	TOTALI I SHËRBIMEVE		Pacienta 7954 Receta 10035
			Fëmijë 3051 Të rritur 4903

MJEKËSIA FAMILJARE NË TEREN

	QMF MILLOSHEVË	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	6515
	Totali i shërbimeve	12640

	Shëndeti Oral – QMF Milloshevë	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	486
	Totali i shërbimeve	1186

	QMF PLEMETIN	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1080
	Totali i shërbimeve	5102

	AMF SIBOC	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2597
	Totali i shërbimeve	7726

--	--	--

AMF BREZNICE		
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1933
	Totali i shërbimeve	4096

AMF B.MOC		
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2528
	Totali i shërbimeve	8458

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS Departamenti i administratës këtë vit ka funksionuar pa ngecje. Në vazhdimësi është raportuar në baza ditore, javore, mujore, është mbajtur evidenca rreth vijimit të punëtorëve. Organizimi i pushimeve vjetore, përpilimi i listave të kujdestarive në vazhdimësi janë përpiluar nga Kryeshefi i Dep të MF, Shefi i Administratës në bashkëveprim me Kryeinfermierën.

TË HYRAT NGA PARTICIPIMI

Data e dorëzimit	Shuma	Vendi ku janë dorëzuar
TOTALI	23973 E	NLB

RAPORT I KARBURANTEVE

	Benzin		Dizell		
JANAR – DHJETOR			10653.01 litra		

Njësia për shërbime teknike

Sa i përket furnizimit me material higjienik ka qenë i kënaqshëm. Higjiena ka qenë në nivel të duhur-me vërejtje të kohëpasëkohëshme

Barnatorja qendrore

Furnizimi me barëra jo i kënaqshëm. Kemi mungesë të madhe me barna nga lista esenciale e barnave. Barërat që kanë arritur në barnatore janë shpërndarë vazhdimisht nëpër QMF dhe AMF. Kërkesat për barëra nga lista esenciale janë dorëzuar në Korporatë me rregull. Po ashtu vlenë të përmendet se furnizimi me insulinë mungon.

ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (ZHVP)

NË QKMF në kuadër të ZHVP-së u mbajtën këto ligjerata për Mjek dhe Infermier:

	Emri & Mbiemri	Tema	Data	Vendi	Organizatori
1.	Dr Muhamet Kozmaqi	Astma	28/01/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
2.	Inf Melihate Hoxha	Kujdesi për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës përfshirë imunizimin	06/01/2021 13/01/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
3.	Dr Xhafer Demiri	Urtikaria dhe angioedema	25/02/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
4.	Inf Fatmire Hashani	Hipertensioni Kujdesi Infermieror	10/02/2021 17/02/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
5.	Dr Gëzim Kaqurri	Reanimimi Kardiopulmonar	25/03/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
6.	Inf Fetije Kurteshi	Reanimimi Kardiopulmonar dhe kujdesi infermieror	10/03/2021 17/03/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
7	Dr Zarije Dulatahu	Astma te adultët	29/04/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
	Inf Elhame Gashi	Procesi i kujdesit	14/04/2021	Salla e	QKMF

8		Infermieror	21/04/2021	trajnimeve QKMF Obiliq	
9	Dr Nurtene Ajrullahu	Kolika renale	27/05/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
10	Inf Zymrije Aliu	Kujdesi shtëpiak, pikllimi dhe humbjae pacientëve në fazën terminale (Kujdesi Infermieror)	12/05/2021 19/05/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
11	Dr Adelina Avdimetaj	Pneumonia te adultët	24/06/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF
12	Inf Shqipe Haliti	Diabeti, kujdesi Infermieror	09/06/2021 16/06/2021	Salla e trajnimeve QKMF Obiliq	QKMF

NË QKMF në kuadër të ZHVP-së u mbajtën 10 ligjerata për Mjek dhe 10 ligjetara për Infermier.

Jashtë Qendrës u mbajtën trajnime dhe takime dhe atë:

95 për Mjek dhe 95 për Infermier.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Ofrimi i Ndihmës Sociale gjatë periudhës Janar- Dhjetor për vitin 2021.

Sipas kushteve dhe kriterëve që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndhimave Sociale për periudhën raportuese e kanë realizuar numri i familjeve si më poshtë:

Numri I familjeve dhe antarëve të familjes së SNS-së sipas muajve Janar-Dhejtor për vitin 2021.

Muaji	Nr.i familjeve në SNS	Antarët e familjes në SNS	Shuma në €
Janar	807	3,331	173,772.50 €
Shkurt	817	3,381	176,240.00 €
Mars	805	3,334	173,402.50 €
Prill	786	3,250	107,896.00 €
Maj	763	3,163	105,512.00 €
Qershor	771	3,196	107,506.00 €
Korrik	774	3,184	105,751.75 €
Gusht	774	3,189	106,094.75 €
Shtator	773	3,207	106,136.00 €
Tetor	767	3,181	105,335.50 €
Nentor	769	3,191	202,616.75 €
Dhjetor	774	3.221	203,861.25 €
Gjithësej:			1,565.988.50 €

Gjatë vitit 2021 kemi këto: Aplikime, Riaplikime, Riaktivizime dhe Ndërprerje.

Muajt	Aplikime	Riaplikime	Riaktivizime	Ndërprerje
Janar	4	88	2	4
Shkurt	5	103	2	11
Mars	6	112	6	16
Prill	2	108	5	15
Maj	2	91	7	15
Qershor	4	74	5	6
Korrik	5	73	2	7
Gusht	3	70	5	12

Shtator	4	75	3	10
Tetor	4	72	5	6
Nentor	3	91	5	8
Dhjetor	2	82	6	13

Lëndët e komisionit mjekësor për muajt Janar –Dhjetor 2021.

	Lëndët e Aprovuara nga K.Mjekësor	Lëndët e refuzuara nga K.Mjekësor	Gjithësej
Janar	7	1	8
Shkurt	10	5	15
Mars	4	5	9
Prill	12	4	16
Maj	10	1	11
Qershor	7	1	8
Korrik	14	3	17
Gusht	5	3	8
Shtator	5	1	6
Tetor	3	2	5
Nentor	10	4	14
Dhjetor			13

- Qendra Për Punë Sociale në bashkëpunim me UNDP-in kanë shpërndarë kupona në vlerë nga 60 € dhe 70 € për gjera ushqimore dhe higjienike, varesisht nga numri I antarëve të familjes. Periudha kohore 6 muaj.

-Numri I familjeve përfituese është 233 familje, të gjitha raste të rënda sociale.

-Me datën 23.08.2021 Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me IOM-in kanë shpërndarë kupona në vlerë prej 70 €, gjëra ushqimore dhe higjienike, periudha kohore 6 muaj nga muaji korrik deri në dhjetor 2021.

Numri I familjeve përfituese është 214 familje raste të rënda sociale nga komuniteti jo shumicë.

- U shpërndanë veshëmbathje për 100 familje, raste të rënda sociale, donator (Dogana) në bashkëpunim me Departementin e Mirëqenjes Sociale në Prishtinë në kuadër të MPMS-së.

Raport i Shërbimeve Sociale dhe Familjare për vitin 2021

Gjatë vitit 2021 në shërbimet sociale dhe familjare janë paraqitur gjithësej 478 raste.

- 1. Fëmijë pa kujdes prindor - 14**
- 2. Strehim familjar tek të afërmit – 13 (prej tyre 4 janë të gjinisë femërore dhe 4 të gjinisë mashkullore). Në familjen strehuese janë 2 fëmijë (njeri I gjinisë femërore , tjetri M).**
- 3. Kërkesa për adoptim vendor - 9**
- 4. Kërkesa për adoptim ndërkombëtar -/**
- 5. Fëmijë I keqtrajtuar - 5**
- 6. Fëmijë me sjellje asociale - 5**
- 7. Përdoruesit e substancave narkotike -/**
- 8. Puna e rrezikshme -11**
- 9. Rrëmbim ndërkombëtar I fëmijëve -0**
- 10. Të miturit në konflikt me ligjin - 19**
- 11. Viktimat e dhunës në familje -34**
- 12. Viktimat e trafikimit- 11 (Viktimë e trafikimit po konsiderohen edhe rastet që detyrohen për lypsari)**
- 13. Viktima e krimeve seksuale - 1**
- 14. Martesa e të miturëve - 2**
- 15. Këshilla martesore (Divorc) - 18**
- 16. Të moshuarit - 2**
- 17. Klientë të tjerë:**
 - A. Me probleme familjare -12**
 - B. Nën vetëushqyese -12**

C. Personat me aftësi të kufizuar - 5

D. Fëmijë me aftësi të kufizuar - 45

E. Aftësia e prindërve nuk është adekuate për përkujdesje ndaj fëmijës – Nuk ka kërkesa

F/1. Vërtetim për armëmbajtje –80

F/2. Vërtetim për punësim - 110

F/3. Vërtetim për SNS -14

F/4. Vërtetim për humbje të shtetësisë - 36

G. Nëna e cila potencialisht do të braktisë fëmijën e saj - 1

H. Nëna e cila e ka braktisur fëmijën e saj -1

I. Babai i cili ka braktis fëmijën e tij -0

J. Regjistrimi i më vonshëm I fëmijëve - 5

K. Arsye tjetër - 16

18. Njoftime me email për trajnime, seminare konferenca etj. -46

19. Raporte bashkëpunuese me OJQ - 12

20. Shkresa administrative - 11

Lidhur me ofrimin e Shërbimeve sociale janë ofruar 530 aktivitete të ndryshme të kategorive sociale si: vizita në shtëpi, intervista, intervenime dhe bashkëpunim ndërinstytucional.

Me organizata kemi mbajtur takime si: OFAP-in, UNICEF-i, KOMF, SOS- Fshati, bashkëpunim me MPMS-në, Komunën, Shtëpinë Strehuese në Prishtinë, Policinë e Kosovës, Gjykatat etj.

DREJTORIA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT– RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-31.12.2021

Aktivitete të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të drejtorisë:

- 1. Monitorimi i gjendjes mjedisore; ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës përmes raporteve mujore nga TC-A, TC-B, Divizionit të Qymyrit dhe raportit të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK), dhe monitori i vendosur në qendër të Obiliqit (sheshi AzizZhilivoda)**
- 2. Pastrimi dhe larja e trotuareve dhe rrugëve – plani i punës me kompaninë “Pastrimi”; Rrugët e kategorisë së parë (zona e parë) një herë në javë, rrugët e kategorisë së dytë dy herë në muaj dhe sipas kërkesave të DMM-së. Në bazë të plani dhe Kontratës.**

3. **Mirëmbajtja e shesheve dhe parqeve – kontrata** “Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave gjelbëruese(kontrata tri vjeçare Mirëmbajtja e parqeve punohet në baza ditore për çdo ditë ndërsa në pllakat përkujtimore tri herë në vit dhe sipas kërkesë së DMM-së).në shtojcë e gjeni planin dhe hapësirën në mirëmbajtje.
4. **Aktivitete ditore në vendbanimet që janë të përfshirë në bartjen dhe grumbullim të mbeturinave komunale – kontrata me kompaninë “Pastrimi” dhe monitorim i vazhdueshëm nga DMM gjatë procesit të marrjes dhe largimit të mbeturinave**
Mënyra e shërbimit të organizuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është i organizuar në formën e bazuar të zonave të banimit brenda komunës. Shpeshtimi i grumbullimit, numri dhe lloji i kontejnerëve është i definuar për tre sektor të banimit:

1. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit kolektiv dhe qendra e qytetit bëhet për çdo ditë;

2. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit individual brenda qytetit bëhet tri herë në javë;

3. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga Sektori i vendbanimeve në zonat rurale në kuadër të komunës bëhet një herë në javë.

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës, në disponim i ka dy kamion (dhe i kryen nga dy udhëtime me kamionë special).

Nëbazë të të dhënave që ka DMM rrejt i mbulushmëris është i shtirë ne ter territorin e komunës se Obiliq shprehur ne % i bie 100 % e territorit ndërsa sa i përket futjes se ekonomive familjare në sistem te marrjes se mbeturinave ne baze te raporti gjendjes faktike ne tren është 80 %. e familjeve janë kyçur ne sistem te mbeturinave .Gjatë viti 2021 janë inkasuar nga KRM-Pastrimi te hyra prej– 304,700.00 €.

duke ju referua te dhënave drejtoria ka parapare gjate këtij viti ti furnizoj pjesën e mbetur te ekonomive familjare me kontejner për ti kyçure ne sistem.

DMM kryen shërbim ne te gjitha institucione publike ne marrjen dhe zbrazjen e kontejnerëve e ne veçanti ne kapin e Plemetin.

1. **Inspektime ditore – në hedhjen e mbeturinave, respektimin e ligjit dhe udhëzimeve për mbeturinat, transporti i tyre e të ngjashme, inspektime në biznese,**

Në kuadër të kompetencave të Ligjit për mbeturina dhe planit për kontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, përmes inspektorit dhe zyrtarëve komunal mjedisor ka realizuar inspektime(kontrolle)të vazhdueshme për të gjithë ata që kanë vepruar në kundërshtim me udhëzimet dhe Ligjet Mjedisore duke u nisur nga Operatorët Ekonomik (OE), që veprojnë në territorin e Obiliqit, mbeturinat, hedhjen e dheut si dhe kamionëve për bartjen e mbeturinave komunale në Deponinë në Mirash. Në vendin e ngjarjes u bënë procesverbale, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin për mbeturina, dhe u shqiptuan edhe gjoba.

2. **Shënimet e ditëve Mjedisore** – Duke pas parasysh që viti 2021 ka qenë vit në të cilin është përhapur pandemia Covid-19, kjo ka ndikuar edhe në aktivitetet mjedisore ku prej shumë aktiviteteve të parapara janë zhvilluar vetëm aktivitetet në largimin e mbeturinave.
3. Pastrimi i deponive ilegale është bërë në bashkëpunim me KEK-unë. Largimi i mbeturinave është bërë në tërë territorin Obiliqit me fshatra. Gjithsej janë larguar mbi 9 deponi ilegale me mbeturina të përziera. Gjithashtu pas largimit të mbeturinave në afërsi të deponis së hirit është bërë rrafshimi i terrenit edhe ri kultivimi mbjellja e drujve.

Projektet dhe detyrat që janë realizuar këtë vit:

DMM kishte planifikuar një plan për realizim të një varg projektsh, po për arsye të gjendjes me pandemi (COVID- 19) një pjesë e tyre janë bartur për vitin 2022.

Projektet e realizuara

- Rregullimi i parqeve në Obiliq; pjesërisht
- Nga KEK-u është investuar në Parkun në rr. "Daut Hashani" në vlerë prej 38,040.36, fusha sportive në rr. Hasna Prishtina në vlerë prej 34,212.14 dhe fusha sportive Plemetin në vlerë prej 24,012.14 .
- **Furnizimi me Kontejner** - DMM ka bërë blerjen e 500 kontejnerëve 120L ku shpërndarja e tyre është bërë të ekonomitë familjare të cilat nuk kanë qenë nëshërbimetëmarrjes së mbeturinave (në mbulimin e shërbimit)
- **Takime dhe inspektime me Inspektoratin mjedisor të MMPH,**

Inspektime të përbashkëta në KEK, Deponia në Mirash, Hekurishte, Fabrika e bllokave në Llazarevë dhe OE te të cilët kanë pasur ndikim në mjedis. Betonjerka, gurthyes, hekurishte, derivatet e naftës biznese.

- Në kuadër të kompetencave që ka DMM ka reaguar (vepruar) në lidhje me KEK-un, gjithnjë duke u bazuar në raport të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK), dhe monitori i vendosur në qendër të Obiliqit (sheshi Aziz Zhilivoda)

- **Inspektime Deponisë Sanitare Mirash, qëllimi dhe rezultati.**

Në kuadër të mbikëqyrjes të aktiviteteve, përputhshmërinë e aktiviteteve me standardet dhe normat ligjore për mbrojtje të mjedisit, është bërë kontrolli në Deponinë Rajonale Mirash, zyrtarët mjedisor në bazë të kompetencave kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe konstatojmë se gjendja në deponi krahasuar me vitet e mëparshëm është dukshëm më e mirë, mirëpo prapë janë dhënë vërejtje që të punohet në bazë të planit operativ ditor si në kompaktin, mbulim, shtresim dhe si problem tjetër ishin qentë endacak, shpezët, insektet dhe minjtë për çka kemi kërkuar që për shkak të sezonës verore të bëhet dezinfektimi i deponisë.

Inspektime dhe kontroll të autotransportuesve për bartjen e mbeturinave;

- Në kuadër të kompetencave të Ligjit për mbeturina dhe planit për kontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, përmes inspektorit dhe zyrtarëve komunal mjedisor ka realizuar kontroll të vazhdueshme kamionëve për bartjen e mbeturinave komunale në Deponinë regjionale sanitare në Mirash. Inspektimi është bërë me Inspektoret komunal dhe u asistua nga Policia e Kosovës, gjegjësisht Stacioni Policor në Obiliq. Aktiviteti i inspektimit u përqendrua në rrugën Dardhishtë – Mirash, dhe në fillim të rrugës “Hasan Prishtina” përkatësisht tek rrethi në Shkabaj. Gjatë kësaj periudhe u ndaluan të gjitha automjetet transportuese që bartnin mbeturina komunale. Në vendin e ngjarjes u bënë procesverbale, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin për mbeturina si dhe u shqiptuan gjoba.

Pjesëmarrje në garën “Mjedis i Pastër” projekt në të cilin kemi fituar 82.000.00€.

Inspektime të të gjithë operatorëve që veprojnë në territorin e Obiliqit – raporti dhe plani i veprimt:

- DMM ka hartuar planin për kontroll dhe inspektim për të gjithë operatorët që veprojnë në Obiliq,

Gjatë kësaj periudhe kohore, inspektorët mjedisor kanë kryer gjithsej:

- 50 kontrollime të ndryshme Rutinore- të planifikuar, (plani)
- 19 vërejtje verbale
- 68 inspektime – sipas kërkesave të qytetarëve (lloji inspektimit).
- Janë shqyrtuar 89 kërkesa të qytetarëve
- Duke respektuar planin gjatë këtij viti janë shqiptuar nëntë (9) gjoba dhe janë plotësuar 25 procesverbale,
- Pëlqimete llojeve të ndryshme

Mbikëqyrje të kryerjes së punëve në projektet:

1. Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara,
2. Furnizimi me kontejner,
3. Rregullimi i parqeve pjesërisht
4. Rregullimi i parqeve dhe fusha sportive me (kek)

Nga DMM gjithashtu janë lëshuar edhe 19 Leje Mjedisore duke mbledhur të hyra në vlerë: **23,452.40 €**, duke respektuar UA për Gjobat Mandatore kemi shqiptuara (9) gjoba duke arritur të mbledhim të hyra në vlerë **1,600.00€**.

Gjithashtu zyrtarët e DMM-së kanë qenë të angazhuar edhe me projekte të drejtorive tjera, duke bërë vlerësim, menaxhim, pranim teknik, subvencione etj.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË – RAPORTI I PUNËS
01.01.2021-31.12.2021

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencapromovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të shërbimeve publike dhe kryen koordinimin e aktiviteteve të tjera ditore, javore dhe mujore.

Prioritetet për vitin 2021

Prioriteti- 1. Ofrimi i shërbimeve komunale sa më cilësore për qytetarët e komunës.

Prioriteti- 2. Shtrirja dhe mirëmbajtja e ndriçimit Publike në qytet dhe fshatra

Prioriteti- 3. Trajtimi i ujërave të zeza fekale dhe atmosferike nëpër fshatra.

Prioriteti- 4. Trajtimi i ujërave të zeza-urbane.

Prioriteti- 5. Trajtimi i hapësirave publike në qytet.

Prioriteti- 6. Ofrimi i shërbimeve publike sa më cilësore.

Prioriteti -7. Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal në territorin e Komunës sonë.

Prioriteti- 8. Investime publike në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Aktivitetet për vitin 2021

- Menaxhimi i situatave emergjente.
- Menaxhimi i Situatës me COVID-19, shpërndarja e pakove ushqimore
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe pastrimi i tyre gjate dimrit.
- Përgatitja e stafit dhe dokumenteve bazë për fatkeqësi natyrore dhe rreziqe tjera.
- Mirëmbajtja dhe deblokimi i kanalizimeve.
- Mirëmbajtja e ndriçimit Publik.
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal.
- Shtrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të -IV.
- Shërbimin e sigurimit të objektit të Kuvendit Komunal.
- Ndërtimi i hapësirave për komunitet
- Digjitalizimi i rrugëve dhe objekteve publike në Komunën e Obiliqit
- Transporti publik lokal

Aktivitet tjera të DSHPE-së

Kemi pranuar 379, kërkesa të ndryshme nga qytetaret, ku janë shqyrtuar 379, të miratuara 187, të refuzuar 181, të anuluar 1,. Duke u bazuar në Kushtet Ndërtimore nga DPUPK-Obiliq janë lëshuar 8 Pëlqime-parimore për kyçe në rrjetin e ujësjellësit dhe në rrjetin elektrik të qytetit dhe 22 pëlqime tjera të natyrave të ndryshme.

Kemi trajtuar raste të intervenimit në deblokim të rrjetit të kanalizimit nëpër qytet dhe fshatra të territorit të komunës sonë. (në bashkëpunim me kompaninë publike KUR-Prishtina njësia në Obiliq.

DSHPE me kompaninë e kontraktuar dhe në bashkëpunim me KEDS-injemi duke bërë dislokimin e trafovenë sheshin “Dëshmorët e Kombit” dhe sheshin “Adem Preniqi” gjithashtunë bashkëpunim me

KEDS-in kemi bërë edhe dislokimin e shtyllave elektrike sipas nevojave të paraqitura në teren si në rastin e ndërtimit të Çerdhes, parqeve apo rrugëve të ndryshme.

DSHPE bazuar në detyrat e saj ka përcjellë punimet në rrënimine tregut të vjetër (ka bërë sigurimin) dhe ka mbikëqyrur punët e kompanisë së kontraktuar nga komuna-DSHPE gjatë rrënitimit.

DSHPE ka raportuar në AEE në kuadër të MZHE përmes pyetësorit për masat efikente të cilat i keni marruar gjatë vitit 2021, (në institucionet komunale). Plotësimi i këtij pyetësori është obligativ sipas Ligjit Nr. 06/L -079, për Eficiencë të Energjisë.

DSHPE në bashkëpunim me MMPH është duke punuar në projektin ËBIF"Vlerësimi paraprak i rrezikut nga vërshimet në pellgun e Lumit Sitnica"që zbatohet nga IPFB(COËI IPF) për zonat e propozuara të rreziqeve të mundshme nga vërshimet.

Në kuadër të drejtorisë SHPE është përgatitur:

- **"Rregullorja për Varreza, ofrimin e shërbimit të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre" si dhe**
- **"Rregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronë publike"** këto Rregullore për shkakë të COVIDIT-19, nuk janë proceduar në Kuvendin komunal e që shpejt do të procedohen për ligjshmëri pran Kuvendit komunal.

Më poshtë kemi renditur projektet që kanë përfunduar dhe projektet që janë vazhdimësi e viteve paraprake dhe që do jenë vazhdimësi në vitin 2021

1. **Projekti:** "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal." është projekt i përfunduar me sukses
2. **Projekti:** Ndertimi I Objekteve për komunitete në Breznicë dhe Kozaricë është projekt i përfunduar me sukses.
3. **Projekti:** "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit" është projekt i përfunduar me sukses.
4. **Projekti:** "Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Obiliq" është kontratë kornizë 2020-2023, projekti është në vazhdimësi duke u realizuar.
5. **Projekti:** "Rregullimi i varrezave dhe mirëmbajtja" është projekt i përfunduar me sukses
6. **Projekti:** "Shtruarja e rrugëve me zhavor" është projekt i përfunduar me sukses.
7. **Projekti:** "Shtrirja e Ndriçimi publik" është projekt i përfunduar me sukses.
8. **Projekti:** "Renovimi i ndërtesave sociale" është projekt i përfunduar me sukses.
9. **Projekti:** "Digjitalizimi i rrugëve dhe objekteve publike në Obiliq" është projekt që ka përfunduar me sukses.

10. **Projekti:** "Mirëmbajtja e Ndrçimit Publik" është projekt në vazhdimësi nga viti 2021 dhe do vazhdoj edhe vitin 2022.
11. **Projekti:** "Ndërtimi i minares së Xhamisë në Lajthisht" është projekt që ka përfunduar me sukses.
12. **Projekti:** "Sigurimi fizik i objektit të Komunës" është kontratë vazhdimësi e viteve paraprake dhe do të vazhdon edhe vitin 2021
13. **Projekti:** "Pastrimi I rrugëve, trotuareve dhe shesheve" është projekt në vazhdimësi nga viti 2021 dhe do përfundoj në vitin 2022.
14. **Projekti:** "Rrënimi I Objekteve, pastrimi I mbeturinave ilegale, pastrimi I shtratit të përrockave, lumenjeve dhe shërbime tjera publike në raste emergjente" është projekt në vazhdimësi nga viti 2020 dhe do vazhdoj edhe vitin 2022.
15. **Projekti:** "Renovimi i zyrave të vendit në Mazgit, Dardhisht, Siboc" është projekt që ka përfunduar me sukses.
16. **Projekti:** "Renovimi i Xhamisë në Siboc dhe fasadimi i objektit për ngushëllime në Plemetin" është projekt që ka përfunduar me sukses.
17. **Projekti:** "Mirëmbajtja e Objekteve Komunale" është projekt që ka përfunduar me sukses.

Më poshtë paraqesim në mënyrë tabelare rastet emergjente në të cilat janë evidentuar nga ana e drejtorisë dhe inspektimet e kryera nga ana e drejtorisë.

Rastet e zjarreve gjatë vitit 2021 në vendbanime të komunës së Obiliqit

Nr.	Vendi	Data	Pronësia	Dëmet	Numri i protokollit	Numri rastev
1.	Plemetin	01.01.2021	Private	Djegje e banesës-brenda	VI-14 15.01.2021	
2.	Obiliq	13.01.2021	Private	Djegje e shtëpisë	VI-15- 15.01.2021	
3.	Milloshëvë	25.02.2021	Private	Djegje e furrës së bukës	VI-138- 02.03.2021	
4.	Plemetin	13.03.2021	Private	Djegje e pajisjeve të punëtorisë	VI-229- 30.03.2021	
5.	Sibofc	10.04.2021	Private	Djegje e shtëpisë	VI-290- 14.04.2021	
6.	Grabofc	13.07.2021	Private	Djegje e ushqimit dhe pyjeve	VI-602- 23.07.2021	